

A iu përgjigjet Perëndia lutjeve tona?

Çfarë duhet që Perëndia t'iu përgjigjet lutjeve tona?

Si të lutemi: Lutjet që marrin përgjigje

A keni njohur ndonjëherë dikë i cili vërtet i beson Perëndisë? Kur isha ateiste, kisha një shoqe të ngushtë e cila lutej shpesh. Çdo javë më tregonte për diçka të cilën ia besonte kujdesit të Perëndisë, dhe çdo javë e shihja Perëndinë të bënte diçka të pazakontë për t'iu përgjigjur lutjes së saj. A e kuptoni se sa e vështirë është që një ateist ta shohë këtë gjë javë pas jave? Me kalimin e kohës, fjala "koincidence" filloi të tingëllojë si një argument shumë i dobët.

Pra, pse u përgjigjej lutjeve të shoqes sime Perëndia? Arsyeja më e madhe ishte se ajo kishte një marrëdhënie me Perëndinë. Ajo donta ta ndiqte Perëndinë, dhe në fakt dëgjonte atë që i thoshte Ai. Në mendjen e saj, Perëndia kishte të drejtën për të drejtuar jetën e saj dhe ajo e mirëpriste duke e lejuar Atë! Kur ajo lutej për gjëra të ndryshme, kjo gjë ishte pjesë e natyrshme e marrëdhënies së saj me Perëndinë. Ajo ndihej shumë rehat duke shkuar tek Perëndia me nevojat e saj, shqetësimet e saj dhe me çfarëdo çështjesh të cilat ishin të pranishme në jetën e saj. Për më tepër, ajo ishte e bindur, nga çfarë lexonte në Bibël, se Perëndia donte që ajo të mbështetej tek Ai në këtë mënyrë. Ajo ishte pasqyrim i thënies nga Bibla e cila thotë: "Kjo është siguria që kemi kur i afrohem Perëndisë: se në qoftë se i kërkojmë diçka sipas vullnetit të Tij, ai na dëgjon."¹ "Sepse sytë e Zotit janë mbi të drejtin dhe veshët e tij janë të vëmendshëm ndaj lutjes së tij..."²

Pra, pse nuk u përgjigjet Perëndia lutjeve të të gjithëve?

Shkaku mund të jetë se nuk kanë një marrëdhënie me Perëndinë. Dikush mund ta dijë se ekziston Perëndia, dhe madje edhe mund ta adhurojë herë pas here. Por ata të cilët duken se nuk kanë marrë asnjëherë përgjigje lutjeje, ka mundësi të mos

kenë një marrëdhënie me Të. Për më tepër, ata nuk kanë marrë kurrë nga Perëndia falje të plotë për mëkatet e tyre. Ç'ka të bëjë *kjo* me atë që ti kërkon? Ja një shpjegim: "Ja, dora e Zotit nuk është tepër e shkurtër për të shpëtuar, as veshi i tij nuk është tepër i rënduar për të dëgjuar. Por paudhësitë tuaja kanë shkaktuar një ndarje midis jush dhe Perëndisë tuaj dhe mëkatet tuaja kanë bërë të fshihet fytyra e Tij prej jush, që të mos ju dëgjojë më."³

Është fare e natyrshme të ndjesh këtë ndarje nga Perëndia. Kur dikush fillon t'i kërkojë Perëndisë diçka, çfarë ndodh zakonisht? Ai fillon me: "Perëndi, kam vërtet nevojë për ndihmën tënde në këtë problem..." Më pas ka një pauzë, dhe fillon sërish ... "E kuptoj që nuk jam i përsosur, që në të vërtetë nuk kam *asnjë të drejtë* të ta kërkoj këtë gjë..." Personi është i vetëdijshëm se ka mëkatuar dhe s'ka qenë ashtu siç duhej të ishte, dhe se nuk është i vetmi në dijeni për këtë; edhe Perëndia është në dijeni. Ai mund të mendojë: "Me kë po tallem unë?" Ajo çfarë mund të *mos* dijë ai është si ta marrë faljen e Perëndisë për mëkatet e tij. Mund të mos e dijë se mund të ketë një marrëdhënie me Perëndinë dhe kështu Perëndia mund ta dëgjojë. Kjo është baza mbi të cilën Perëndia iu përgjigjet lutjeve.

Si të lutemi: Themeli

Së pari, duhet të fillosh një marrëdhënie me Perëndinë. Përfytyro sikur një djalë me emrin Majk të vendosë t'i kërkojë presidentit të Universitetit të Prinstonit (të cilin Majku nuk e njeh fare) të nënshkruajë bashkë me të një hua makine për të. Mundësitë e Majkut që *kjo* të ndodhë janë zero (nëse presidenti i Prinstonit është në rregull mendërisht). Megjithatë, nëse e bija e të njëjtit president do t'i kërkonte të atit të nënshkruante për të, nuk do të ishte aspak problem. Ka shumë rëndësi marrëdhënia.

Me Perëndinë është kështu: kur dikush është fëmijë i Perëndisë, kur ai i përket Perëndisë, Perëndia e njeh dhe ia dëgjon lutjet. Jezusi tha: "Unë jam bariu i mirë dhe i njoh delet e mia dhe ato më njohin mua...delet e mia e dëgjojnë zërin tim. Unë i njoh dhe ato më ndjekin, dhe unë iu jap atyre jetën e përjetshme dhe ato nuk do të humbasin kurrë; askush nuk mund t'i rrëmbejë nga

dora ime."⁴

Pra, kur bëhet fjalë për Perëndinë, a e njeh vërtet Atë dhe a të njeh Ai ty? A ke një marrëdhënie me Të që për ligj përgjigjet e lutjeve prej Tij? Apo Perëndia është tepër larg, pak a shumë një koncept në jetën tënde? Nëse Perëndia është i largët, apo nuk je i sigurt se e njeh Perëndinë, ti mund të fillosh një marrëdhënie me të pikërisht tani: [Lidhje](#).

A do t'i përgjigjet patjetër Perëndia lutjes suaj?

Për ata që e njohin atë dhe mbështeten tek Ai, Jezusi duket se është mjaft bujar me ofertën e tij: "Nëse qëndroni në mua dhe fjalët e mia qëndrojnë në ju, kërkonte ç'të doni dhe do t'ju jepet."⁵ Të "qëndrosh" në Të dhe fjalët e Tij të qëndrojnë në ty, do të thotë që përmes jetës tënde të tregosh se e njeh Atë, mbështetesh tek Ai dhe dëgjon Atë që Ai thotë. Më pas, mund t'i kërkosësh çfarë të duash. Ja dhe një kriter tjetër: "Kjo është siguria që kemi para Tij: në qoftë se kërkojmë diçka sipas vullnetit të Tij, Ai na dëgjon. Dhe nëse e dimë se Ai na dëgjon-- çfarëdo t'i kemi kërkuar--e dimë se i kemi çfarë i kërkuam atij."⁶ Perëndia iu përgjigjet lutjeve tona sipas vullnetit të tij (dhe sipas urtësisë së tij, dashurisë së tij për ne, shenjtërisë së tij, etj.).

Ajo që na ngatërron ne është se e marrim të mirëqenë njohjen e vullnetit të Perëndisë, thjesht sepse diçka ka kuptim për ne! Ne supozojmë se ka vetëm një "përgjigje" të duhur për një lutje specifike, duke supozuar sigurisht se AI do të ishte vullneti i Perëndisë. Këtu vështirësohet çështja. Ne jetojmë brenda limiteve të kohës dhe limiteve të njohurisë. Kemi vetëm informacion të kufizuar për një situatë dhe se çfarë do të ndodhë me atë situatë në të ardhmen. Të kuptuarit e Perëndisë nuk është i kufizuar. Ç'vend zë një ngjarje në rrjedhën e jetës apo të historisë është diçka që vetëm Ai e di dhe Ai mund të ketë qëllime përtej asaj që përfytyrojmë ne. Me një fjalë, Perëndia nuk do ta bëjë diçka thjesht sepse ne e vendosëm që ashtu duhet të jetë vullneti i Tij.

Çfarë kërkohet? Çfarë është i gatshëm të bëjë Perëndia?

Mund të mbusheshin faqe të tëra me synimet e Perëndisë për ne. E tërë Bibla është një përshkrim i llojit të marrëdhënies që Perëndia dëshiron të kemi me të dhe i llojit të jetës që dëshiron të na japë. Ja disa shembuj:

"...Zoti do të presë për t'ju dhënë hir, pastaj ai do të lartësohet, sepse i erdhi keq për ju, sepse Zoti është një Perëndi i drejtësisë. Lum të gjithë ata që kanë shpresë tek ai."⁷ A kapët këtë? Ashtu si dikush ngrihet nga karrigia e tij për t'ju ardhur në ndihmë, "ai lartësohet, sepse i erdhi keq për ju." "Rruga e Zotit është e përsosur...ai është mburoja e të gjithë atyre që gjejnë strehë tek ai."⁸ "Zoti kënaqet me ata që kanë frikë prej tij [që e nderojnë], me ata që shpresojnë në mirësinë e tij."⁹

Megjithatë, shfaqja më e madhe e dashurisë dhe përkushtimit të Perëndisë ndaj nesh është kjo: Jezusi tha: "Askush s'ka dashuri më të madhe nga kjo: të japë jetën e vet për miqtë e tij,"¹⁰ gjë të cilën Ai e bëri për ne. Dhe po ashtu: "Nëse Perëndia është me ne, kush mund të jetë kundër nesh? Duke qenë se Perëndia nuk kurseu Birin e tij, por e dha për të gjithë ne, qysh nuk do të na dhurojë të gjitha gjërat bashkë me të?"¹¹

Po për lutjet "e papërgjigjura"?

Sigurisht, njerëzit sëmuren, madje edhe vdesin; problemet financiare janë reale dhe mund të ndeshesh me të gjitha llojet e situatave. E atëherë?

Perëndia na thotë t'ia dorëzojmë shqetësimet tona Atij. Edhe kur situata mbetet e zyrtë, "Hidheni tërë merakun tuaj mbi të, sepse ai merakoset për ju."¹² Rrethanat mund të duken jashtë kontrollit, por nuk është kështu. Kur e tërë bota duket se po të bie mbi kokë, Perëndia mund të të japë zemër. Ky është çasti kur një person mund të jetë shumë mirënjohës që e njeh Perëndinë. "Zoti është afër. Mos u shqetësoni, por në çdo gjë ia parashtroni Perëndisë me anë lutjesh dhe përgjërimesh, me falënderim. Dhe paqja e Perëndisë që ia tejkalon çdo zgjuarsie, do të ruajë zemrat tuaja dhe mendjet tuaja në Krishtin Jezus."¹³ Perëndia

mund të sigurojë rrugëdalje, zgjidhje për problemin më shumë nga ç'mund ta përfytyroni ju. Ndoshta çdo i krishterë mund të renditë shembuj si këto në jetën e tij. Por nëse rrethanat nuk përmirësohen, Perëndia mund të na japë ende paqen e tij në mes të gjithë kësaj. Jezusi tha: "Unë po ju lë paqen, po ju jap paqen time: unë po jua jap, po jo si e jep bota; zemra juaj mos u trodittë dhe mos u frikësoftë."¹⁴

Është në këtë çast (kur rrethanat janë ende të vështira) që Perëndia na kërkon të vazhdojmë t'i besojmë Atij--të "ecim me besim, jo me anë të vizionit [të asaj që shohim]", - thotë Bibla. Por nuk është besim i verbër. Bazohet në vetë karakterin e Perëndisë. Një makinë që kalon një urë mbështetet tek fortësia e urës. Nuk ka rëndësi se çfarë mund të ndjejë shoferi apo të mendojë, apo të bisedojë me atë që është në vendin e pasagjerit. Ajo që bën të mundur kalimin e makinës në anën tjetër është fortësia e urës, të cilës shoferi ishte i gatshëm t'i besonte.

Në të njëjtën mënyrë, Perëndia na kërkon t'i besojmë besueshmërisë së Tij, karakterit të Tij...dhembshurisë, urtësisë, drejtësisë, dashurisë së Tij për ne. Ai thotë: "Të kam dashur me një dashuri të përjetshme; prandaj të kam tërhequr me dashamirësi."¹⁵ "Ki besim tek ai vazhdimisht, o popull, hap zemrën tënde para tij. Perëndia është streha jonë."¹⁶

Si përfundim...Si të lutemi

Perëndia u ka ofruar përgjigjje lutjeve të fëmijëve të Tij (ata të cilët e kanë pranuar Atë në jetën e tyre dhe kërkojnë ta ndjekin Atë). Ai na kërkon të çojmë çdo shqetësim tek Ai në lutje dhe Ai do të veprojë në lidhje me të sipas vullnetit të Tij. Ndërsa përballëmi me vështirësi, ne duhet t'i hedhim shqetësimet tona tek Ai dhe të marrim nga Ai një paqe që i sfidon rrethanat. Baza për shpresën dhe besimin tonë është karakteri i vetë Perëndisë. Sa më mirë ta njohim, aq më të prirur do të jemi për t'i besuar Atij.

Për më shumë mbi karakterin e Perëndisë, ju lutem shikoni [Kush është Perëndia?](#) ose artikuj të tjerë në këtë faqe. Arsyeja për

lutjet tona është karakteri i Perëndisë. Lutja e parë së cilës i përgjigjet Perëndia është lutja jote për të filluar një marrëdhënie me Të.

Artikull nga Marilyn Adamson

[1] 1 Gjoni 5:14 [2] 1 Pjetër 3:12 [3] Isaia 59:1,2 [4] Gjoni 10:14,27-28 [5] Gjoni 15:7 [6] 1 Gjonit 5:14,15 [7] Isaia 30:18 [8] Psalmet 18:30 [9] Psalmet 147:11 [10] Gjoni 15:13 [11] Romakëve 8:32 [12] 1 Pjetër 5:7 [13] Filipianëve 4:5-7 [14] Gjoni 14:27 [15] Jeremia 31:3 (rsv) [16] Psalmet 62:8